

Tirane, me 15.08.2024

Drejtuar : Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Rruga: "Ibrahim Rugova" Nr.4, Tirane

Ne vemendje te: Znj. Majlinda Çelmeta

Objekti: Njoftim per mosrealizimin e Kontrates se Sherbimit per
Auditimin Vjetor per subjektin "Partia Nacionaliste Shqiptare"

Te nderuar Zoterinj,

Ne baze te Kontrates nr.2225prot., date 27.07.2024 lidhur me Komisionin Qendror te Zgjedhjeve (KQZ) ne cilesine e ekspertes kontabel te licensuar (auditueses ligjore) me misionin e auditimit te detyrueshem te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve per vitin kalendarik 2023 per subjektin "Partia Nacionaliste Shqiptare", ju bej me dije si me poshte vijon:

Menjehere pas lidhjes se kontrates se sherbimit me KQZ-ne, 30.07.2024 kerkuam te vendosnim komunikim zyrtar me subjektin "Partia Nacionaliste Shqiptare" per fillimin e procedurave te auditimit, nepermjet dergimit me poste te nje shkrese informuese me kthim pergjigje ne adresen e selise se partise ne dispozicion nga KQZ-ja.

Kjo menyre komunikimi rezultoi pa sukses, pasi nga posta letra u kthye mbrapsht ne adresen tone me pergjigjen: "adrese e pamjaftueshme".

Gjithashtu, nga ana jone u bene perpjekje per te gjetur te dhena dhe kontakte te tjera online dhe nga auditues te meparshem per kete subjekt, por pa rezultat.

Ne besojme se kemi bere perpjekjet e duhura per te vendosur komunikim zyrtar me Kryetarin e "Partia Nacionaliste Shqiptare" dhe personat e tjere pergjegjes ne kete parti, por kjo ishte e pamundur. Si rrjedhoje misioni i auditimit per "Partia Nacionaliste Shqiptare" nuk u realizua.

Bashkengjitur ketij informacioni: Letra e derguar me poste, konfirmimi i sherbimit postar per dergimin e kesaj letre me kthim pergjigje.

Ju faleminderit per mirekuptimin!

